



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

NJOFTIM

**MBI VETËKANDIDIMIN PËR ANËTARIN STUDENT TË KOMISIONIT TË
KËRKIMIT, PROJEKTEVE DHE BOTIMEVE SHKENCORE**

Në zbatim të nenit 38 pika 1 (gërma i), nenit 46 pika 3 dhe 6 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenit 20 (gërma nj) si dhe nenit 26 të Statutit të UST-së, Nenit 4 të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Përhershëm, në Nivel Institucioni, për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore, nenit 22, 23, 24 të Rregullores për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST,

Ftoheni të vetëkandidoheni për të qënë anëtarë të këtij Komisioni, nëse plotësoni kriteret e përcaktuara në pikën 4 të nenit 22 të Rregullores për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST. Regjistrimin mund ta bëni në zyrën e Protokoll-Arkivës së UST-së, **nga data 09.01.2023 deri në datë 13.01.2023 brenda orës 15:00.**

Mbetemi në pritje të vetkandidimeve tuaja, në mënyrë që në mbledhjen e radhës së Senatit Akademik, të përzgjidhet student i cili do të jetë anëtar i Komisionit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

Faleminderit për mirëkuptimin!